

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6538
E premte, 18 shkurt 2022
çmimi 0.40 €

Kushtetuesja nuk e shkarkon presidentin Meta



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KOSOVA KA SHËNUAR TË ENJTEN 14-VJETORIN E SHTETËSISË

14 VJET SHTET, PA PROTAGONISTËT E PAVARËSISË



Më 17 shkurt 2022 Kosova ka shënuar 14-vjetorin e shtetësisë. Në praninë e krerëve më të lartë shtetërorë, presidentes Vjosa Osmani, kryetari të Kuvendit, Glauk Konjufca dhe kryeministrit Albin Kurti, pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) kanë bërë ngritjen solemne të flamurit të Kosovës para objektit të qeverisë. Më pas Kuvendi ka mbajtur një seancë solemne për ta shënuar 14-vjetorin e shtetësisë, në të cilën është thënë se sakrifica për ta bërë shtetin ka qenë jashtëzakonisht e madhe. Ndërkaq në sheshin "Zahir Pajaziti" në Prishtinë kanë parakaluar solemnisht kuadrat e ushtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe pjesëtarët e Policisë së Kosovës

OPINION

QËNDRIMI I FAKTORIT
NDËRKOMBËTAR NDAJ KËRKESAVE
TË SHOQIPTARËVE TË KOSOVËS PËR
PAVARËSI 1990-1999 F. 5

Prof. dr. Sabit SYLA




AKTUALE



MUHAMET MAVRAJ:
KJO MANIFESTURË KOMUNISTE
NUK DO TË HARROHET! F. 3

ARRESTOHEN GJASHTË PERSONA
PËR KULTIVIM DHE SHITJE TË
NARKOTIKËVE F. 6

EKONOMI



TREGU I SERBISË NË KOSOVË
ZVOGËLOHET PËR RRETH
37 PËR QIND F. 7

TERMOCENTRALI MË I MADH I
AUSTRALISË DO TË MBYLLET NË
VITIN 2025 F. 8

SPORT

NDESHJE JETIKE PËR 'DARDANËT'
KUNDËR NORVEGJISË F. 10

Zelensky e pranon se anëtarësimi në NATO ka "ngecur" F. 2

Pesë të vdekur dhe 411 raste të reja me Covid F. 2



FSK-ja dhe policia e Kosovës kanë parakaluar në sheshet e Prishtinës për nder të 17 shkurtit F. 4-5

RENOVA
PUTZ
Magedoni Xhepçisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Zelensky e pranon se anëtarësimi në NATO ka "ngecur"

KIEV, 17 SHKURT - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, ka deklaruar të enjten se Kievi ka pasur shanse për t'u bashkuar me NATO-n. Por, sipas tij, pavarësisht prej ambicieve të shtetit të tij, brenda aleancës ka pasur rezistencë për mosanëtarësimin e Ukrainës. "Ne si vend do të donim të bashkoheshim me NATO-n, por procesi ka ngecur. Janë disa arsye për këtë. Jo vetëm Rusia është kundër anëtarësimin të Ukrainës në NATO", ka thënë ai për të përditshmen gjermane "Bild". Zelensky ka theksuar se ka vende anëtare të NATO-s që

mbështesin Moskën për pozicionin e saj kundër anëtarësimin të Ukrainës. Ai nuk pranoi t'i përmendte vendet, duke shtuar se "nuk e kemi të lehtë me këto vende dhe nuk duam asnjë rrezik apo konflikt diplomatik". Zelensky ka thënë se populli ukrainas duhet të jetë në gjendje të vendosë nëse do t'i bashkohet NATO-s, por se një referendum në këtë pikë do të kishte pak kuptim. "Rruga për në NATO dhe BE është shumë e gjatë. Ukraina ka nevojë për disa garanci sigurie gjatë rrugës", tha ai, duke kërkuar mbështetjen e vendeve anëtare të NATO-s.

"NATO është garancia për sigurinë, këtë duam të arrijmë. Kjo garanci për ne do të thotë se ne nuk do ta humbim pavarësinë", ka pohuar ai. Ukraina ka thënë prej kohësh se dëshiron t'i bashkohet aleancës ushtarake. Kremlini këmbëngul se NATO nuk duhet ta pranojë kurrë Ukrainën dhe duhet t'i tërheqë forcat e saj pranë kufijve të Rusisë. Por Perëndimi ka refuzuar atë që e quan ofertë nga Moska për të diktuar të ardhmen e partnerëve të pavarur dhe e kërcënoi Moskën me "kosto të rënda" nëse sulmon Ukrainën.



Mjekët turq, në grevë për paga dhe kushte më të mira



ANKARA, 17 SHKURT - Mjekët në Turqi kanë nisur ditën e dytë të grevës të enjten, duke protestuar kundër pagave të ulëta dhe kushteve të rënda të punës, ndërkohë që ky shtet përballet me turbulencat më të këqija ekonomike në dy dekadat e fundit. Anëtarët e sindikatës së mjekëve kanë ndalur punën dhe në rrjetet sociale janë shfaqur klinika të thata në disa qytete dhe provinca. "Mjekët janë në grevë sepse nuk duan të

punojnë nën kushtet njerëzore", ka thënë kjo sindikatë në "Twitter", duke përmendur pagat, punën me orar të gjatë dhe rritjen e dhunës fizike nga pacientët. Një total prej 316 punëtorëve shëndetësorë janë shënjestruar në 190 sulme të ndara më 2021 në Turqi, sipas të dhënave në sindikatën lokale Saglik-Sen. Të mërkurën presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan ka thënë se inflacioni gati 50 për qind është "i përkohshëm" dhe se

qytetarët do të duhet ta mbajnë barrën mbi supet për një periudhë. Oraret e gjata të punës në periudhën e pandemisë kanë nxitur shumë mjekë turq të largohen nga shteti. Sipas Asociacionit të Mjekëve të Turqisë, më shumë se 1 400 mjekë janë larguar nga Turqia më 2021, në krahasim me vetëm 59 një dekadë më parë. Një mjek i ri në Turqi merr pagë mujore prej 404 dollarësh amerikanë.

Dhjetëra persona të vdekur pas vërshimeve në Brazil

PETROPOLIS, 17 SHKURT - Gati 100 persona kanë vdekur si pasojë e rrëshqitjeve të dheut dhe vërshimeve në qytetin brazilian Petropolis, kanë thënë zyrtarët. Ky qytet, i cili gjendet afër maleve të Rio de Zhaneiros është goditur nga shira të rrëmbyeshëm. Shtëpitë janë shkatërruar dhe veturat i ka marrë uji. Ekipet e kërkim-shpëtimit janë duke gërmuar baltën për të gjetur

ndonjë të mbijetuar. Mbrojtja Civile Kombëtare e Brazilit ka thënë në "Twitter" se 24 persona janë shpëtuar të gjallë deri më tani, ndërsa 94 vdekje janë konfirmuar. "Situata është gati si luftë. Makina të varura, makina të përmbysura, shumë baltë dhe ujë", ka thënë guvernatori i Rio de Zhaneiros, Claudio Castro, para gazetarëve. Petropolis është destinacioni i

njohur për turistët. Presidenti brazilian, Jair Bolsonaro, i cili është në vizitë zyrtare në Rusi, ka thënë se do të organizojë ndihmë të menjëhershme për viktimat. Kjo është një nga seritë e shirave të rrëmbyeshëm që kanë goditur Brazilin në tre muajt e fundit. Shkencëtarët kanë thënë se kjo situatë po përkeqësohet nga ndryshimet klimatike.



Franca dhe aleatët do t'i tërheqin trupat nga Mali



PARIS, 17 SHKURT - Franca dhe aleatët e saj në forcën evropiane do t'i tërheqin trupat e tyre nga Mali pas gati një dekade, ka thënë presidenti francez Emmanuel Macron. Këto trupa kanë qenë të përfshira në luftën kundër militantëve

islamike në këtë shtet prej vitit 2013. Macron ka thënë se ky vendim ka ardhur pas përkeqësimit të marrëdhënieve diplomatike dhe rritjes së armiqësive nga junta ushtarake e Malit. Këto forca tani do të pozicionohen diku tjetër në

rajonin Sahel. "Ne nuk mund të mbesim të angazhuar ushtarakisht me autoritetet de-fakto, meqë nuk ndajmë strategjitë dhe qëllimet e tyre të fshehta", ka thënë Macron në një konferencë për medie në Paris. Ai ka hedhur poshtë

pretendimet se tërheqja është pranim i dështimit dhe ka insistuar se Franca vazhdon të jetë e përkushtuar për luftim të kryengritjeve islamike në rajon. Macron ka shtuar se Nigeri është pajtuar për të qenë nikoqir i disa trupave.


Muhamet Mavraj: Kjo manifesturë komuniste nuk do të harrohet!



PRISHTINË, 17 SHKURT (ER) - Botuesi i gazetës "Epoka e re", Muhamet Mavraj, ka reaguar pasi në hollin e Kuvendit të Kosovës disa fëmijë (nxënës) janë fotografuar duke mbajtur fotografi në duar të kryetarit të Kuvendit, Glauk Konjufca dhe të presidentes Vjosa Osmani. Mavraj në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se ky veprim komunist nuk do të harrohet. Fotografimi i nxënësve është bërë në kuadër të aktiviteteve për Ditën e Pavarësisë.

SHKRIMI I PLOTË I MAVRAJ:

Miq,
Kjo nuk do të harrohet!
Nuk i besoj më nderit të detyrës nga disa mësues e drejtorë shkollash!
Shokë dhe shoqe të Stanit, drugovi i drugarice, nuk bën kështu, ju ka mbetur ora prapa, në Jugosllavi! E papranueshme dhe rreptësisht e dënueshme që shkollat e Prishtinës dhe udhëheqësit e sotëm politikë t'i përdorin fëmijët tanë, pa lejen tonë, për planprogramet e tyre çfarëdo, në frymën e festës së pavarësisë, për të cilën, fundja, atë ditë, më 17.2.2008, janë mërztitë! Nesër mund të turpërohen rëndë këta fëmijë për këto foto, kur ta kuptojnë se janë fotografuar e keqpërdorur në këtë masë edhe nga të akuzuarit për krime financiare ose të tjera që i kane kryer ose mund t'i kryejnë ndërkohë që ata rriten!



Asgjë nuk më ka pështirosur sa vrasjet me "Delta", për çka ende paguajnë këta fëmijë me mësimet plotësuese të shtunave

dhe eksploatimi flagrant haptas i po këtyre fëmijëve si në kohën e komunizmit jugosllav. Këtu asnjë krim publik nuk po

ndëshkohet por, në mënyrë speciale, kjo manifesturë komuniste nuk do të harrohet! Ai Stan atë bulmet ka!

Kushtetuesja nuk e shkarkon presidentin Meta

TIRANË, 17 SHKURT - Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë ka vendosur kundër shkarkimit të presidentit të vendit Ilir Meta, duke shfuqizuar votimin e Kuvendit për shkarkimin e kreut të shtetit. Gjykata ka thënë se nuk ka shkelje të rëndë të Kushtetutës nga ana e presidentit të Shqipërisë, Ilir Meta. "Gjykata Kushtetuese, pasi verifikoi procedurën e ndjekur nga Kuvendi për ngritjen e komisionit hetimor, garantimin e së drejtës së presidentit për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur dhe duke mbajtur në konsideratë pavarësinë organizative të Kuvendit, në tërësi konstatoi se nuk ka pasur shkelje kushtetuese gjatë kësaj procedure", thuhet në njoftimin e Gjykatës Kushtetuese. Deputetët e Partisë Socialiste të kryeministrit Edi Rama kishin themeluar një komision hetimor për ta hetuar presidentin Meta për shkeljen e



Kushtetutës para dhe gjatë fushatës zgjedhore të zgjedhjeve qendrore në prill të vitit 2021. Deputetët, pas gjetjeve të komisionit, më 9 qershor të vitit 2021, votuan në favor të shkarkimit të presidentit me 104 vota, duke thënë se ai ka shkelur

Kushtetutën e Shqipërisë dhe se "me veprimet, sjelljet dhe mesazhet e dhëna në publik nuk ka garantuar unitetin kombëtar, nuk ka moderuar konfliktin politik, por përkundrazi e ka nxitur atë në terma të tilla, të cilat sollën si pasojë daljen e

organizuar të militantëve të partive politike në rrugë duke terrorizuar qytetarët, duke kufizuar lirinë e tyre të lëvizjes si dhe lirinë personale, deri në kryerjen e konflikteve me armë". Neni 90 i Kushtetutës së Shqipërisë parasheh

shkarkimin e presidentit nga Kuvendi për shkelje të rëndë të Kushtetutës dhe për kryerjen e një krimi të rëndë. Sipas këtij neni, propozimi për shkarkimin e presidentit në raste të tilla mund të bëhet nga të paktën një e katërta e anëtarëve të Kuvendit apo 35 deputetë nga 140 sa i ka Kuvendi i Shqipërisë. Presidenti Meta kishte deklaruar se nuk do të njohë asnjë veprimtari të një kuvendi "njëpartiak" dhe se do ta ushtrojë detyrën e tij deri më 24 korrik të vitit 2022. Ai këtë deklaratë e bëri pasi shkarkimi i tij u votua në një kohë kur opozita e Shqipërisë kishte djegur mandatet e veta në Kuvend.

Meta është zgjedhur president më 28 prill 2017 me 87 vota, me mbështetjen e Partisë Socialiste dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim, të cilën e drejtonte vetë Meta. Mandati i presidentit është pesëvjeçar dhe roli i tij është kryesisht protokollar.

Zyrtarët e PDK-së vizituan prindërit e Thaçit për 14-vjetorin e pavarësisë së Kosovës

SKENDERAJ, 17 SHKURT (ER) - Nënkryetari i komunës së Skenderajt, Sami Lushtaku, bashkë me nënkryetaren e PDK-së, Vlora Çitaku, kanë vizituar familjen e ish-presidentit Hashim Thaçi. Me rastin e 14-vjetorit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës, Lushtaku, Çitaku

dhe deputetët Ganimete Musliu dhe Mërgim Lushtaku qëndruan në shtëpinë e familjes Thaçi në Burojë. "Sa mikpritës e sa të dashur janë nana Hyrë e baba Haxhi. Të shtyer në moshë e të lodhur nga sfidat e jetës por gjithmonë ballëhapur e krenarë që

Kosovës i dhanë një personalitet si Presidenti Hashim Thaçi. Rrofshin gjatë këta prindër fisnikë e pritshin edhe shumë përvjetorë të tjerë të pavarësisë, bashkë me Presidentin Hashim Thaçi!", ka shkruar në llogarinë e vet në "Facebook", Sami Lushtaku.





KOSOVA KA SHËNUAR TË ENJTEN 14-VJETORIN E SHTETËSISË

14 vjet shtet, pa protagonistët e pavarësisë

Më 17 shkurt 2022 Kosova ka shënuar 14-vjetorin e shtetësisë. Në praninë e krerëve më të lartë shtetërorë, presidentes Vjosa Osmani, kryetarit të Kuvendit, Glauk Konjufca dhe kryeministrit Albin Kurti, pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) kanë bërë ngritjen solemne të flamurit të Kosovës para objektit të qeverisë. Më pas Kuvendi ka mbajtur një seancë solemne për ta shënuar 14-vjetorin e shtetësisë, në të cilën është thënë se sakrificat për ta bërë shtetin ka qenë jashtëzakonisht e madhe. Ndërkaq në sheshin “Zahir Pajaziti” në Prishtinë kanë parakaluar solemnisht kuadratet e ushtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe pjesëtarët e Policisë së Kosovës

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 SHKURT- Të enjten Kosova ka shënuar 14-vjetorin e shtetësisë së saj, por në këtë përvjetor të shtetësisë nuk ishin prezentë protagonistët e pavarësisë, të cilët ndodhën në paraburgim në Hagë për të rikonfirmuar edhe një herë se lufta çlirimtare e Kosovës që çoi deri në shpalljen e kësaj date, 17 shkurt 2008, ka qenë e drejtë dhe e pastër në mbrojtje të popullit të saj.

Në praninë e krerëve më të lartë shtetërorë, presidentes Vjosa Osmani, kryeministrit Albin Kurti dhe kryetarit të Kuvendit, Glauk Konjufca, pjesëtarët të Forcës së Sigurisë së Kosovës kanë bërë ngritjen solemne të flamurit të Kosovës para objektit të Qeverisë.

Më pas, Kuvendi i Kosovës ka mbajtur një seancë solemne për të shënuar 14-vjetorin e shtetësisë.

Për nder të 14-vjetorit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës, në sheshin “Zahir Pajaziti” në Prishtinë parakaluan solemnisht kuadratet e

ushtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe pjesëtarët të Policisë së Kosovës.

Në kuadër të shënimit të 14-vjetorit të shpalljes së pavarësisë, presidentja Vjosa Osmani, kryeparlamentari Glauk Konjufca dhe kryeministri Albin Kurti, kanë bërë homazhe

dhe vendosur lule në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz të Skenderajt. Më pas, të tre drejtuesit më të lartë institucionalë bënë nderime dhe vendosën kurora me lule te varri i ish-presidentit të Kosovës, Ibrahim Rugova dhe te varri i veprimtarit të çështjes kombëtare, Adem Demaçi. Presidentja Osmani në fjalimin e saj ka uruar qytetarët për 14-vjetorin e shtetit tonë. “Natyrisht që edhe në këtë ditë, sikur çdo ditë të punës e përpjekjeve tona dua ta shfrytëzoj për t’i falënderuar dhe t’i nderuar të gjithë ata që kanë dhënë gjithçka në mënyrë që sot ne ta gëzojmë shtetin që e kemi, duke filluar nga vizionari dhe arkitekti i

pavarësisë së Republikës së Kosovës, presidenti Rugova i cili diti ta qartësoj vullnetin e popullit të Kosovës para botës dhe të krijoj miqësi të cilat edhe sot i gëzojmë dhe duke vazhduar me mbi 3 mijë dëshmorë të cilët flijuan jetën e tyre në mënyrë që sot të jetojmë të lirë të udhëhequr nga komandanti legjendar Adem Jashari dhe familja Jashari”, ka thënë Osmani.

Ajo ka theksuar se sakrificat për shtetin tonë ka qenë jashtëzakonisht e madhe. E para e vendit ka thënë se shteti ynë është punë e përfunduar dhe me 17 shkurt 2008 është përcaktuar njëherë e përgjithmonë.





Edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka thënë se sot është dita më e rëndësishme e republikës sonë, Dita e Pavarësisë, e cila mishëron dhe sublimon përpjekjet dhe sakrificën e të gjitha gjeneratave, për lirinë tonë politike.

Kreu i Kuvendit ka thënë se vet fakti që kjo ditë po fillon me ngritjen e flamurit të shtetit tonë, është një simbolikë që tregon se shteti ynë do të qëndrojë lart dhe i paepur përgjithmonë. "Sot këtë ditë të rëndësishme të shtetit tonë do të shënojmë me aktivitete të shumta, ashtu siç e meriton ajo, prandaj shfrytëzoj rastin që të gjithë qytetarëve të Kosovës t'ua uroj Ditën e Pavarësisë", ka thënë Konjufca.

Ai ka thënë se përkulet para luftës së shenjtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ndërsa pavarësia është bimë e lirisë që kërkon të ujitet çdo ditë.

Edhe kryeministri Kurti ka uruar qytetarët e vendit për Ditën e Pavarësisë, por me të marrë fjalën ai, opozita ka lëshuar seancën e Kuvendit.

Në fjalën e tij para deputetëve, Kurti ka thënë se sot është ditë feste për të gjithë neve. "Është ditë ku për disa çaste lëmë mënjane dallimet tona të

dëbuar e për të pushtuar këto troje. "E përkundër gjithë atyre luftërave e padrejtësive, populli ynë asnjëherë nuk u shndërrua në popull sundues e pushtues. Në fakt, populli ynë është ndër popujt e rrallë paqedashës në botë, të cilët janë pushtuar shpesh, kanë luftuar vazhdimisht kundër okupatorëve, por kurrë nuk kemi pushtuar popuj tjerë.



Andaj edhe nuk është çudi që përkundër që jemi shteti më i ri në Evropë, ne kontribuojmë shumë për paqen dhe demokracinë", ka thënë Kurti, duke falënderuar ata që kontribuuan për këtë ditë. "Sot,

ish aktivistë politikë, ish studentë e qytetarë, deri tek ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, secili në kapacitetet e role e tyre që dhanë maksimumin që sot të gëzojmë këtë ditë. Historia e Kosovës do të njuh vuajtjet, sakrificën dhe kontributin e secilit", ka thënë Kurti.

Shpallja e Pavarësisë së Kosovës është bërë më 17 shkurt të vitit 2008 në orën 15:39 në Kuvendin e Republikës së Kosovës në Prishtinë. Në një mbledhje të jashtëzakonshme ku merrnin pjesë 109 nga gjithsej 120 deputetë, Kuvendi i Kosovës njëzëri shpalli Kosovën shtet të pavarur, sovran dhe demokratik. Ligjshmëria e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës për një kohë ka qenë temë e diskutueshme. Serbia duke kundërshtuar deklaratën e Pavarësisë së Kosovës kërkonte vlerësimin e vlefshmërisë ndërkombëtare dhe mbështetje për pozicionin e saj, gjoja se deklarata e Pavarësisë së

Kosovës ishte e paligjshme. Në vazhden e kësaj ecurie, në tetor të vitit 2008, Serbia kërkoi një opinion këshillues nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. Më 22 korrik të vitit 2010, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë përmes një Vendimi Këshillëdhënës rikonfirmoi se deklarata e Pavarësisë së Kosovës nuk ka shkelur asnjë nen të Ligjit Ndërkombëtar.

Shpallja e Pavarësisë së Kosovës ishte bërë nga kryeministri i atëhershëm i Kosovës, Hashim Thaçi. "Ne, udhëheqësit e popullit tonë, të zgjedhur në mënyrë demokratike, nëpërmjet kësaj deklarate shpallim Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Kjo shpallje pasqyron vullnetin e popullit tonë dhe është në pajtueshmëri të plotë me rekomandimet e të dërguarit special të Kombeve të



përditshme për ta shënuar këtë moment arritje që në shumë aspekte përbënë arritjen e gjeneratave të shqiptarëve ndër shekuj. Shpallja e pavarësisë ishte padyshim rezultat i luftës tonë çlirimtare, kauzës tonë të drejtë për vetëvendosje dhe solidarizim i botës demokratike", ka deklaruar Kurti.

Ai ka theksuar se historia na mëson se e kaluara jonë është ajo mes të drejtës dhe sakrificës së vazhdueshme për të jetuar të lirë në trojet tona dhe përballjes me synimet e të tjerëve për të na

përveçse festojmë këtë datë historike, ne nderojmë e falënderojmë ata që kontribuuan për këtë ditë. E në radhë të parë janë dëshmorët tanë të cilët dhanë gjithçka për të ardhmen tonë; është Shqipëria dhe mbarë kombi ynë; janë figurat historike sikurse Hasan Prishtina e Isa Boletini, Azem Bejta e Shotë Galica, Shaban Polluzha e Tahir Meha, Adem Demaçi, Fehmi Agani e Ibrahim Rugova, dhe familja Jashari e kryekomandanti Adem Jashari. Janë edhe qindra gra dhe burra,



Kryetari i PDK-së viziton familjen e Hashim Thaçit, Kadri Veselit dhe të Jakup Krasniqit

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, i shoqëruar nga nënkryetarja Vlora Çitaku dhe sekretari Bajrush Xhemajli, ka vizituar të enjten familjet e krerëve të UÇK-së që ndodhen në paraburgim në Hagë, ndërsa pasdite ka takuar edhe ish-presidentin Fatmir Sejdiu i cili më 2008, bashkë me Hashim Thaçin dhe Jakup Krasniqin, udhëhoqën institucionet e vendit në shpalljen e pavarësisë më 17 shkurt 2008.



Bashkuara, Martti Ahtisaari, dhe propozimin e tij

gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës", thuhej në deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

"Newborn"-i edhe në këtë përvjetor ka marrë pamje të re. Ideatori i këtij monumenti "Newborn", Fisnik Ismaili, ka thënë se këtë herë mesazhi që përcillet përmes pamjes së re të "Newborn"-it pasqyron suksesin e grave të Kosovës dhe të gjitha grave që s'janë më, si shkak i dhunës në familje.

Me rastin e 14-vjetorit të pavarësisë së Republikës së Kosovës, shumë personalitete botërore kanë uruar për këtë ditë qytetarët e Kosovës.

Qëndrimi i faktorit ndërkombëtar ndaj kërkesave të shqiptarëve të Kosovës për pavarësi 1990-1999



Prof. dr. Sabit SYLA

Fillimi i viteve 1980 shënon një pikë kthese në historinë e popujve që jetonin në Jugosllavi. Kriza e rëndë ekonomike që kishte filluar të gjunjëzonte ekonominë jugosllave, që krahasohej me një deficit tregtar e përkeqësim të borxhit të jashtëm që shkante deri në 15 miliardë dollarë në vitin 1980 e me një inflacion deri në 20%, u shoqërua me dy ngjarje të rëndësishme që do t'i jepnin një drejtim tjetër zhvillimeve politike në Jugosllavi. Vdekja e Josip Broz Titos më 1980 dhe demonstratat studentore shqiptare të vitit 1981 ndikuan në zgjimin dhe daljen e hapur në skenë të nacionalizmit serb, i cili në mënyrë latente, ndonëse i pafuqishëm, i kishte rezistuar aq sa kishte mundur reformave decentralizuese në Jugosllavi që nga viti 1965. Tek qarqet intelektuale, kulturore e religjioze serbe filloi një propagandë gjithnjë e më e fuqishme e cila vinte theksin në padrejtësitë që i ishin bërë popullit serb që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore. Arsyetimet e shumta e të ndryshme mbi vuajtjet e serbëve dhe mënyrat për t'i korrigjuar

ato, u artikuluan në mënyrë të qartë në "Memorandumin" e vitit 1986 të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Republikës së Serbisë. Në fakt, e gjithë esenca e "Memorandumit" pasqyrohej tek decentralizimi i Jugosllavisë dhe tek rregullimi kushtetues, sidomos i Serbisë në raport me krahinat, që do të konsideroheshin si zanafilla për të gjitha problemet pasuese. Në rastin e parë, atë të decentralizimit, qarqet serbe brengoseshin se në rast të shpërbërjes së Jugosllavisë populli serb copëtohej në disa shtete, duke hapur kështu "çështjen serbe", kurse në rastin e dytë, Kushtetuta e vitit 1974 i ofronte Kosovës disa tipare, sikurse: e drejta për miratimin dhe ndryshimin e kushtetutës; e drejta për organizim autonom të qeverisjes; pavarësia e sistemit gjyqësor etj., duke ngritur kështu dyshimet për një ndarje të mundshme të Kosovës nga Serbia në të ardhmen. Në këtë mënyrë para klasës politike të Serbisë u vu si detyrë kryesore suprimimi i autonomisë së krahinave, respektivisht reduktimi i kompetencave të tyre ekzekutive e legislative. Realizimi i një detyre të tillë do të merr një karakter më të vendosur pas ardhjes së Sllobodan Millosheviqit në krye të Komitetit Qendror të Lidhjes Komuniste të Serbisë, më 1987. Millosheviqi hartoi një strategji politike për Kosovën bazuar në atë çfarë shihej si interesi nacional serb. Mënyra e tij e

arsyetimit ishte e thjeshtë: nëse Serbia nuk arrin ta rimerr kontrollin mbi Kosovën, atëherë ky do të jetë fundi i kombit serb. Vite më vonë, do të bëhej e qartë se Kosova kishte qenë vetëm fillimi i fushatës nacionaliste dhe ekspansioniste për t'i bashkuar "gjihtë serbët në një shtet". Për të realizuar objektivin e tij politik Millosheviqi mbështeti mitemingjet e solidaritetit që serbët e malazetët nga Kosova mbanin në qytetet e Serbisë e Malit të Zi, për të dëshmuar "të vërtetën për Kosovën", që në fakt promovonin idenë për ndryshimin e kushtetutës. Objektivi tjetër i mitemingjeve ishte edhe ndryshimi i udhëheqjes politike në Vojvodinë e në Mal të Zi dhe zëvendësimi i tyre me njerëz besnik të programit serb. Rënia e udhëheqjes së Vojvodinës në tetor 1988 e më pas edhe të Malit të Zi në janar 1989, i hapën rrugë Millosheviqit që tërë energjinë ta fokusonte në drejtim të Kosovës me synim eliminimin e autonomisë së saj. Mbledhja e 23 marsit 1989 e Kuvendit të Kosovës u shoqërua me një presion të jashtëzakonshëm psikik e fizik nga qarqet politike e policore serbe mbi delegatët e Kuvendit të Kosovës. Po ashtu demonstratat popullore në mbrojtje të Kushtetutës rezultuan me një dhunë policore që la 22 demonstrues të vrarë, shumë të lënduar e 647 të burgosur. Kështu, më 23 mars të vitit 1989, në Kuvendin Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, në kundërshtim me vullnetin e

qytetarëve dhe të një pjese të deputeteve shqiptarë, do të ndryshohet Kushtetuta e vitit 1974, me çka suprimohet autonomia politike e Kosovës në Federatën Jugosllave, duke e lënë Kosovën si pjesë përbërëse të Serbisë. Konfirmimi përfundimtar i amendamenteve pastaj u votua në një sesion të jashtëzakonshëm e solemn të Kuvendit të Serbisë në Beograd më 28 mars 1989. Në këtë mënyrë Serbia vendosi kontrollin mbi gjithë fushën ekonomike-shoqërore, gjyqësorinë, policinë, mbrojtjen civile të Kosovës etj. Duke mos u pajtuar me ndryshimet e dhunshme, delegatët e Kuvendit të Kosovës më 2 korrik 1990 miratuan Deklaratën Kushtetuese, përmes së cilës Kosova shpallej njësi e barabartë me njësitë tjera të ish Jugosllavisë. Miratimi i Deklaratës në fjalë u pasua nga reagimi energjik i Kuvendit të Serbisë i cili përmes ligjit nr. 33/90 ndaloi veprimtarinë e Kuvendit të Kosovës dhe të Këshillit Ekzekutiv të Kosovës (qeverisë), duke përvetësuar kështu edhe funksionet që ushtronin institucionet e Kosovës. Suprimimi i autonomisë së Kosovës, më 1989, dhe uzurpimi i institucioneve dhe kompetencave legislative e ekzekutive të shoqëruara me dhunën policore, vuri shqiptarët e Kosovës para një dileme - si të vazhdohej më tutje? Kosova ndodhej para një udhëkryqi historik - të pranohej në heshtje realiteti i ri dhe t'i

nënshtroheshin regjimit serb apo të ndiqej aspirata shekullore e popullit shqiptar në Kosovë për liri e demokraci. Periudha në fjalë shënonte edhe konsolidimin e forcave të reja politike shqiptare që lindën si rezultat i pluralizmit. Nën drejtimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës, si një forcë numerikisht më e madhe e unike në ish Jugosllavi, ku bashkohej gjithë intelijenca e kohës, shqiptarët e Kosovës avancuan kërkesat e tyre politike. Në një mbledhje të organizuar në Kaçanik delegatët e Kuvendit të Kosovës shpallën më 7 shtator 1990 Kushtetutën e Kosovës, kurse referendumi për Kosovën si Shtet të Pavarur e Sovran, i shtatorit 1991, shënonte një transformim në kërkesat e shqiptarëve të Kosovës nga mundësia e bashkëjetesës me kombet e mbetura në Jugosllavi në opsionin e pavarësisë. Duke u bazuar në miratimin e akteve të mësipërme klasa politike e Kosovës punoi në dy drejtime: në sensibilizimin e çështjes së Kosovës në arenën ndërkombëtare dhe në konsolidimin e brendshëm duke ndërtuar institucionet paralele shtetërore, përkundër dhunës së vazhdueshme serbe. Kërkesat e udhëheqjes politike të shqiptarëve të Kosovës për njohje të kërkesave për liri e pavarësi dhe qëndrimi i faktorit ndërkombëtar karshi tyre mund t'i periodizojmë në tre faza: (1) qëndrimi i faktorit ndërkombëtar gjatë viteve 1990-1992; (2) 1995-1997, dhe (3) 1998-1999. (Vijon)

Arrestohen gjashtë persona për kultivim dhe shitje të narkotikëve

PRIZREN, 17 SHKURT (ER) - Me urdhër të Prokurorisë Themelore në Prizren, Policia e Kosovës, respektivisht Njësi të Hetimit e Trafikimit të narkotikëve në Prizren, ka realizuar një aksion për bastisje në një lokacion me dyshimin për trafikim të narkotikëve. Prokuroria Themelore në Prizren ka njoftuar lidhur me këtë rast, duke bërë me dije se hetimet kanë filluar më 4 shkurt 2022 ndaj tre personave. "Pas sigurimit të provave të nevojshme është realizuar bastisja në fshatin Shirokë-komuna e Suharekës, në një objekt shtatë kate, nën kulmin e të cilit është gjetur një laborator për kultivimin e bimëve të kanabisit. Me rastin e bastisjes janë kapur në flagrancë dhe janë arrestuar gjashtë persona, katër prej tyre shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe dy shtetas të Republikës së Kosovës, nën dyshimin e bazuar se kanë kryer veprat penale 'Kultivimi i

bimës së hashashit, shkurre së kokainës ose bimëve të kanabisit', nga neni 272, paragrafi 1, lidhur me nenin 31, dhe 'Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge', nga neni 267, paragrafi 1, lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)", ka njoftuar Prokuroria Themelore në Prizren. Nga ky aksion janë gjetur rreth 32 kilogramë e llojit marijuanë, dy mijë e pesëdhjetë e nëntë bimë të mbjella në saks, të cilat janë konfiskuar, si dhe narkotikë që kanë qenë të përgatitura dhe të gatshme për shitje. "Vendi (laboratori) ku janë gjetur narkotikët i ka pasur të gjitha pajisjet e nevojshme për kultivimin e bimës së kanabisit si: ndriçimin e posaçëm, sistemin e ujitjes, sistemin e ajrosjes, peshore, qese, si dhe sasi të konsideruar të dheut të vendosura në thasë. Nga ky



aksion janë sequestruar tri automjete të markave BMW, Ford dhe Opel Zafira; gjashtë celularë; para të gatshme 2 185.29 euro,

313 denar maqedonas; një DVR; dhe një lloptop. Po ashtu, lidhur me këtë rast hetimet do të vazhdojnë, ndërsa për të

arrestuarit nga prokurori i çështjes është lëshuar vendimi për ndalim 48 orësh", ka njoftuar Prokuroria Themelore në Prizren.

Tregu i Serbisë në Kosovë zvogëlohet për rreth 37 për qind



PRISHTINË, 17 SHKURT - Sasia e prodhimeve të Serbisë në tregun e Kosovës ka rënë për gati 37 për qind vitin e kaluar në krahasim me vitin 2017, tregojnë të dhënat e Doganave të Kosovës. Sipas llogaritjeve të tyre, vlera e importit të mallrave serbe në Kosovë ka qenë 450 milionë euro në vitin 2017, apo 36.8 për qind më shumë se në vitin 2021, kur ky import ka arritur në 305 milionë euro.

“Radio Evropa e Lirë” ka kontaktuar Odën Ekonomike të Serbisë dhe disa kompani të këtij vendi që eksportojnë në Kosovë, të tilla si “Metalac”, “Point Group”, “Mladost” dhe “Polimark”, por ato nuk kanë dashur të flasin për vlerën e eksporteve të tyre në Kosovë.

“Alco Group”, një ndërmarrje që përfshin disa marka prodhuesish nga Serbia, si “Pionir” i çokollatave dhe ëmbëlsirave dhe “Hisar” i produkteve të frutave dhe perimeve, ka konfirmuar për REL-in se eksportet e tyre në Kosovë “kanë rënë për një

moment”, por nuk kanë dhënë më shumë detaje. “Për sa iu përket vlerave të eksporteve [sa eksportojnë dhe a kanë pasur humbje], nuk flasim dhe kaq”, kanë thënë shkurtimisht nga “Alco Group”.

Afaristë dhe qytetarë që kanë folur për REL-in në Prishtinë kanë thënë se pas aplikimit të taksës 100 për qind për produktet e Serbisë dhe pastaj masës së reciprocitetit, ata nuk u janë rikthyer mallrave serbe.

Për gati dy dekada deri në vitin 2018, Serbia ka qenë shteti me sasinë më të madhe të mallrave në tregun e Kosovës. Gjatë një dite ky shtet ka eksportuar në Kosovë mallra në vlerë rreth 1.2 milion euro. Shumica e eksporteve kanë qenë nga industria ushqimore dhe ndërtimore.

Në nëntor të vitit 2018 Qeveria e Kosovës, e udhëhequr në atë kohë nga kryeministri Ramush Haradinaj, ka vendosur taksë doganore 100 për qind ndaj mallrave të importuara nga

Serbia dhe Bosnjë- Hercegovina - të dyja vende që s’e njohin Kosovën - me qëllim të, siç ka thënë, forcimit të prodhimit vendor, të ekonomisë dhe të shtetësisë së Kosovës.

Pas më shumë se një viti, taksa është zëvendësuar me reciprocitet nga Qeveria e Kosovës, e cila edhe atë kohë është udhëhequr nga kryeministri aktual Albin Kurti. Reciprociteti ka nënkuptuar që produktet serbe të lëshoheshin në përputhje me ligjet e Kosovës, gjë që ka nxitur reagime dhe kundërshtime nga Serbia.

Reciprociteti është hequr pas rreth 50 ditësh nga pasuesi i Kurtit në atë kohë, Avdullah Hoti. Mbi një vit e gjysmë taksa dhe reciprociteti kanë bërë që prania e prodhimeve serbe në tregun e Kosovës të zvogëlohet gradualisht, ashtu si edhe kërkesa për to.

Sipas Doganave të Kosovës, vlera e importit nga Serbia - nga 450 milionë euro sa ka qenë në vitin

2017, ka rënë në 389 milionë euro më 2018, në 6 milionë më 2019, ndërsa është ringritur në 174 milionë më 2020 dhe në 305 milionë më 2021. “Para vitit 2018, para taksës, edhe unë kam blerë produkte serbe. Nuk e kam shikuar prejardhjen”, ka thënë Jasmina Hasangjekaj, një konsumatore që po furnizohej në një dyqan ushqimor në Prishtinë. “Pas vendosjes së taksës dhe tash, në 99 për qind të rasteve, e shikoj prejardhjen e produktit. Nëse është nga shteti i Serbisë, nuk e blej. Tash edhe i njoh produktet e tyre dhe nuk i vendos në shportë”, thotë ajo.

Nga zinxhiri i dyqaneve ushqimore në Kosovë “Viva Fresh” konfirmojnë për REL-in se qysh pas vendosjes së taksës “ka pasur ulje të konsumit të produkteve me origjinë nga Serbia” dhe rritje të konsumit të produkteve të Kosovës, por edhe të vendeve të tjera, si: Maqedonia e Veriut apo Turqia.

Fidaim Rushiti, pronar i një dyqani ushqimor në qendër të

Prishtinës, thotë se kërkesat e tanishme për produkte nga Serbia nuk krahasohen me ato të viteve para 2018-s. “Në dyqanin tim ka rënie deri në 70 për qind të blerjes së produkteve serbe në krahasim me vitet paraprake. Kështu që edhe unë kam zvogëluar sasinë e importit, sepse nuk kërkohen. Ato produkte, sidomos biskotat, çokollatat, keçapi, majonezi, që dikur janë shitur shumë, sot kërkohen pak”, thotë Rushiti.

Kryetari i Aleancës Kosovare të Biznesit, Agim Shahini, thotë se mungesa për një periudhë e produkteve të Serbisë në tregun e Kosovës, i ka drejtuar qytetarët dhe tregtarët kah zgjedhjet alternative. Ai shton se si blerësit, ashtu edhe tregtarët, ndikohen edhe nga çmimi. “Qytetarët i dëshirojnë produktet vendore, por prapëseprapë, kur është në pyetje çmimi, i ndërrojnë ato me çfarëdo produktesh që gjenden në dyqan dhe vitrinë”, thotë Shahini.

Të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) tregojnë se nga viti 2018 sasia e produkteve gjermane në tregun e Kosovës është rritur për 13 për qind, e produkteve nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut për rreth 6 për qind dhe e atyre nga Kroacia për 3 për qind.

Pavarësisht prej përpjekjeve për normalizimin e marrëdhënieve, në kuadër të bisedimeve që ndërmjetëson Bashkimi Evropian, Kosova dhe Serbia vazhdojnë të përballen me barrierat e ndryshme tregtare.

Vitin e kaluar vlera e eksportit të Kosovës në Serbi, sipas ASK-së, ka qenë 42 milionë euro, më 2020 ka qenë 30 milionë euro, ndërsa më 2019 - 27 milionë euro. Këto vlera janë shumë më pak se ato të eksporteve të Serbisë në Kosovë gjatë viteve. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë disa herë se reciprociteti do të jetë parim, mbi të cilin do të bazohen veprimet e shtetit të Kosovës, dhe se nuk ka hequr dorë nga vendosja e reciprocitetit të plotë me Serbinë. “Kosova dëshiron që reciprociteti i plotë me Serbinë të bëhet në atë mënyrë që të mos zhbëhet më”, ka deklaruar Kurti në muajin gusht të vitit të kaluar por, deri më tash, nuk ka diçka konkrete në terren.

Pesë të vdekur dhe 411 raste të reja me Covid

PRISHTINË, 17 SHKURT (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se nga 3 820 testimet, 411 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit janë shënuar pesë raste të vdekjes. Sot janë shëruar edhe 2 582 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve

është 214 885.

Në total numri i rasteve aktive me Covid është 6 509.

Në 24 orët e fundit jepen 1 275 doza të vaksinës kundër Covidit Ministria e Shëndetësisë ka bërë me dije se në 24 orët e fundit janë dhënë 1 275 doza të vaksinës kundër Covid-19.

Prej fillimit të vaksinimit në të

gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 805 533 doza të vaksinës.

Deri më sot 812 299 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë.

Deri më sot janë dhënë 95 264 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.



Me vendim të ZRRE-së aplikimi i tarifave të reja fillon nga 9 shkurti

PRISHTINË, 17 SHKURT (ER) - KESCO ka njoftuar që me vendimin e ZRRE-së tarifat e reja do të fillojnë së aplikuari nga 9 shkurti. "Mënyra e implementimit të llogaritjes së konsumit është marrja e konsumit në total dhe ndarja në mesatare ditore. Me këtë metodologji të propozuar nga KESCO është pajtuar edhe ZRRE-ja. Në mënyrë që të evitohet çdo keqkuptim, konsumi do të kalkulohet në dy

pjesë, nga data e leximit të faturës deri më 9 shkurt dhe nga 9 shkurt e deri në datën e leximit. Faturimi deri më 9 shkurt do të llogaritet me tarifë të vjetër. Pastaj do të bëhet kalkulimi tjetër me tarifë të re", ka njoftuar KESCO.

Më tutje theksohet se edhe nëse i keni shpenzuar më tepër se 800 kWh deri më 9 shkurt, ato nuk do të llogariten për të hyrë në bllok tarifë, por kalkulimi do të fillojë sërish nga zero deri në

datën e leximit. "Me anë të kësaj metode pjesa më e madhe e konsumatorëve do të lirohen nga bllok tarifa, edhe pse kanë shpenzuar mbi 800 kWh. Konsumatorët do të njoftohen lidhur me shpenzimin me tarifa të vjetra dhe të reja në faturat e fundit që do t'i pranojnë gjatë ditëve në vijim. Pastaj konsumi që fillon pas dërgimit të faturës së ardhshme e tutje do të fillojë të njehsohet me tarifa të reja", ka njoftuar KESCO.



Mustafa: Kemi dështuar të tërheqim më shumë investime në sektorin privat

PRISHTINË, 17 SHKURT - Njohësi i mirë i zhvillimeve ekonomike të vendit, themelues dhe këshilltar senior në Institutin Riinvest, Muhamet Mustafa, ka deklaruar se Kosova ka dështuar me modelin e zhvillimit ekonomik, apo të rritjes ekonomike, e cila është bazuar në faktorët eksternë - asistencë financiare nga jashtë, remitanca e të tjera, për ta servisuar konsumin dhe jo në modelin që rritë ofertën vendore. "Përpos në infrastrukturë, Kosova ka pasur nevojë për më shumë investime, po ashtu edhe të bëjë një lloj riindustrializimi për ta krijuar ofertën vendore, njëkohësisht për të krijuar më shumë vende pune. Përgjatë tërë periudhës thuaja 20-vjeçare kemi dështuar të tërheqim më shumë investime në sektorin privat. Pra, kemi investuar më pak se sa është dashur për rreth 7 për qind - 10 për qind të GDP-së", ka deklaruar ai. Ai ka theksuar se si vend kemi dështuar edhe në vendosjen e një sistemi të konkurrencës fer ngaqë shpesh importet kanë ndodhur të kenë një pozitë më të favorshme në tregun vendor sesa prodhuesit vendorë. "Funksionimi i gjyqësorit në fushën komerciale gjithashtu ka qenë shumë problematik. Zgjidhja e konteksteve biznesore zgjatë shumë. Më shumë se 4 e 5 vjet dhe kjo tremb investitorët. Edhe toleranca ndaj korrupsionit, sidomos e forcave politike por edhe e gjyqësorit, deri diku edhe e opinionit, sidomos komunitetit të biznesit, ka ndikuar negativisht në



vëllimin e investimeve", ka pohuar Mustafa në një intervistë për "Buletin Ekonomik".

Ndërsa, shkaqet, sipas profesor Mustafës, duhet kërkuar në disa rrafshe.

Së pari te qeverisja ekonomike, më saktë ajo makroekonomike, që thotë se nuk ka pasur një filozofi të duhur zhvillimi, përpos një vizioni rreth infrastrukturës

rugore, kurse në sektorët e tjerë ka qenë pothuajse pa koncept, pa plan dhe e përcjell me veprime ad-hoc. "Thuajse të gjitha kabinetet qeveritare, deri kah viti 2015, çështjet e reformës dhe politikave ekonomike ua kishin lënë organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare. Pra, jo gjithëherë ishin të thelluara në matriksin ekonomik dhe social

të Kosovës", ka thënë Mustafa. Sipas tij, shkakun duhet kërkuar edhe te mungesa e llogaridhënies, në rend të parë të kabineteve qeveritare, pastaj edhe të bordeve dhe ekipeve menaxheriale në sektorët e ndryshëm ekonomikë. Mustafa ka thënë se Kosova ka rrezik ta humbë një nga përparësitë kryesore për zhvillim,

popullsinë e re. Ai ka theksuar se qeveria aktuale duhet ta lehtësojë zhvillimin e biznesit, duke vazhduar luftimin e korrupsionit dhe zbatimin e ligjit dhe duke promovuar konkurrencën e barabartë, me një përkrahje të bizneseve vendore, me masa indirekte që ta përballojnë konkurrencën e jashtme dhe të vazhdojë rritjen e eksportit.

Termocentrali më i madh i Australisë do të mbyllet në vitin 2025

PRISHTINË, 17 SHKURT - Termocentrali më i madh me thëngjill në Australi do të mbyllet shtatë vjet më herët sesa është planifikuar, ka njoftuar kompania që menaxhon atë, Origin Energy, duke deklaruar se nuk ka kapacitete për të garuar me "fluksin e burimeve të ripërtërishme".

Termocentrali me kapacitet 2.88 gigavatë gjendet afër Sidnejt. Ai do të mbyllet në vitin

2025 dhe do të zëvendësohet nga një bateri e madhe. Ky termocentral i bashkohet një liste të gjatë të objekteve të tilla që mbyllen teksa rritet kërkesa për energji të erës dhe atë solare. "Tregu i energjisë në Australi sot është shumë më ndryshe prej atij që ishte në fillim të viteve 1980", ka thënë Frank Calabria, shef ekzekutiv i kompanisë Origin.

Varësia e Australisë ndaj termocentraleve me thëngjill ka

rënë në vitet e fundit. Megjithatë, thëngjilli është ende furnizues i 60 për qind të energjisë në këtë shtet, duke e bërë Australinë një nga vendet me emetimin më të madh të karbonit për kokë banori. Burimet e ripërtërishme përbëjnë rreth një të tretën e prodhimit të energjisë në Australi dhe kjo shifër parashihet të shkojë në deri 70 për qind deri në fund të dekadës. (rel)



MUHAMET MAVRAJ, KUVEND PËR UÇK NË MES TË PRISHTINËS



Ismet SYLEJMANI

Roli i personalitetit në histori, gjithmonë ka qenë rol i rëndësishëm së veçantë dhe vendimtarë në periudha të ndryshme për fatet dhe të ardhmen e poullit, Atdheut dhe Kombit!

Këtë rol, si askush e ka luajtur atdhetari e patrioti i madh, politikani trim e besnik i interesave të Atdheut, gazetari legjendarë i popullit shqiptar Muhamet Mavraj!

Më 15 Janar 1999, shqiptari heroik, me zemren mal, në cilësinë e Kryetarit të Kuvendit, nënshkruan DEKLARATË historike e shekullore të Kuvendit të Unionit të Pavarur të Studentëve të Universitetit të Prishtinës!

Në mes të Prishtinës të stërmbyshur me ushtri e polici serbe, njësi speciale e paramilitare të ndryshëm nga Serbia, para syve e në hundë të UDB-së, i madhi Muhamet Mavraj, ka kryesuar Mbledhjen historike të Kryesisë së Kuvendit të UPSUP-së!

Kryetari i Parlamentit të studentëve të 15 Janarit të vitit 1999, vitit të UÇK-së, ish i burgosuri politik Muhamet Mavraj, në atë vit të madh e vendimtar për luftën e armatosur çlirimtare për liri të popullit shqiptar të Kosovës, ka vënë firmën me dorën e Tij, në DEKLARATËN historike, në atë dokument heroik, ku i jepej mbështetje e pazezerve Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës! Në DEKLARATËN e Kuvendit

të UPSUP-së, që mban firmën e Muhamet Mavrajt, thirrja dhe mbështetja për UÇK-në është absolute, është totale! Dhe kjo DEKLARATË e firmosur nga titani Muhamet Mavraj, do të ishte normale sikur të ishte atje lartë në male, ose në metropolet e ndryshme botërore, por jo, kjo DEKLARATË është nënshkruar në Kosovën e robëruar nga Serbia dhe, në kohën kur xhelati e kriminelu Milosheviq, ishte në kulmin e pushtetit të tij absolut!

Studentet dhe studentët shqiptar, jo vetëm të Kosovës, jo vetëm të Shqipërisë, jo vetëm të Maqedonisë së Veriut e jo vetëm të Luginës së Preshevës, por anë e kënd globit, Ty të kanë pasur e do të të kenë busullën e madhe dhe yllin e madh ndriqes, se si duhet të vëshesh me vendosmëri e trimëri të madhe dhe si luan të qëndrosh i patundur në istikamin e frontit të çlirimtarit të popullit, Atdheut dhe Kombit!

Ti je lindje e madhe e popullit shqiptar!

Ti je burrë i madh e i lavdishëm i Atdheut!

Ti je figurë e madhe dhe e ndritur e Kombit!

Kjo DEKLARATA e datës 15 Janar të vitit 1999, e Kuvendit të UPSUP-së, do të shkruhet me shkronja ari dhe Ti i dashur dhe shumë i nderuar Muhamet Mavraj, do të mbetesh në historinë e madhe e të ndritur të popullit shqiptar, atje lartë të rreshti lavdimadhi, ku rrijtë e vështrojnë hijerëndë, kryekuvendarët e mëdhenj të kuvendeve të mëdha e historike të Kombit tonë!

Faleminderit Nënë Zojës, që të ka lindur kaq të madh e kaq të lavdishëm!

Prishtinë, 16 Shkurt 2022!



Image of a newspaper page from 'EPOKA E RE' with the headline 'Kuvend për UÇK-në' and a list of 11 points from the 'DEKLARATË'.

EURO GLASS
SAINT-DORAIN SEKURIT
PILKINGTON Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

'BUJOËSIA'

TEL: 045/82 82 82

Ndeshje jetike për 'Dardanët' kundër Norvegjisë

PRISHTINË, 17 SHKURT - Kosova më 27 shkurt do të përballet me Norvegjinë në "Minatori" të Mitrovicës. Takimi që zhvillohet nga ora 19:00 është në kuadër të rrethit të parë të parakulifikimeve për FIBA Eurobasket 2025. Në sfidën e parë mes tyre fitoi Norvegjia me shifrat 86:77 dhe "Dardanët" duhet të fitojnë me dhjetë pikë

dallim në mënyrë që të jenë më të mirë në ndeshjet direkte. Ndërkohë, Kosova arriti një fitore të madhe, duke mundur Danimarkën me shifrat 78:33. Në Grupin C, fillimisht më 24 shkurt, do të zhvillohet dueli mes Danimarkës dhe Norvegjisë, ndërsa më 27 shkurt zhvillohet përballja Kosova - Norvegjia. Më 30 qershor

zhvillohet sfida në mes të Danimarkës dhe Kosovës, kurse më 3 korrik dueli i fundit në grup ndërmjet Norvegjisë dhe Danimarkës. Momentalisht Norvegjia ka një fitore, Kosova një fitore dhe një humbje, si dhe Danimarka një humbje. Vendi i parë kualifikohet në rrethin e ardhshëm, si vendi i dytë më i mirë nga tri grupet.



SHKURT

Bekteshi vazhdon karrierën në Norvegji

Ish-mbrojtësi i Gjilanit dhe Prishtinës, Leotrim Bekteshi, ka arritur marrëveshje me skuadrën IF Mjondalen, që garon në ligën e dytë në Norvegji. Këtë e ka bërë publike edhe klubi, duke paraqitur lojtarin në rrjetet sociale. Bekteshi, së fundi, ishte pjesë e FC Prishtinës, me të cilën doli kampion si dhe përfaqësoi klubin në garat evropiane. Ai ka qenë pjesë e Gjilanit dhe Besës në futbollin e Kosovës. 30-vjeçari është larguar nga Kosova për t'iu bashkuar gruas së tij, e cila prej vitesh jeton në Norvegji.

Pas Newcastleit, Strakoshën e kërkon edhe Watfordi

Portieri i kombëtares shqiptare, Thomas Strakosha, do të largohet nga Lazio në fund të këtij sezoni dhe po kërkon një skuadër të re. Duket se në Premierë Ligë po kërkohen shumë shërbimet e gardianit kuqezi. Pas Newcastleit, tani në garë ka hyrë edhe Watfordi. Duket se portieri veteran i ekipit, Ben Forster, do të largohet nga ekipi, kështu që klubi po kërkon një portier për ta zëvendësuar. Strakosha duket se i plotëson kriteret që një ekip si Watfordi kërkon, por gjithsesi transferimi duket i vështirë për shkak të gjendjes që ndodhet ekipi në renditjen e Premierë Ligës, i cili ndodhet në zonën e rënies.

UEFA dhuron 6 000 bileta falas për finalen e Ligës së Konferencës në 'Air Albania'

Finalet e kompeticioneve evropiane po afrojnë dhe UEFA ka vendosur t'i gëzojë tifozët. Organizata më e lartë e futbollit në Evropë do të dhurojë bileta falas për klubet finaliste të Ligës së Kampionëve, Ligës së Evropës dhe Ligës së Konferencës. Do të jenë në total 30 mijë bileta falas për tifozët, të cilat do të ndahen respektivisht: 10 mijë për Ligën e Kampionëve (5 mijë për secilin klub finalist), 8 mijë për Ligën e Evropës, 6 mijë për Ligën së Konferencës dhe 6 mijë për Women Champions League. Dy klubet që do të mbërrijnë deri në finalen e madhe në Tiranë do të kenë nga 3 000 bileta secili në dispozicion për t'i shpërblyer tifozët e tyre më besnikë. Pra në total 6 000 bileta në "Air Albania" janë dhuratë e UEFA-s për tifozët e skuadrave që do të mbërrijnë në finale. E gjitha kjo bëhet në shenjë shpërblimi për mbështetjen që tifozët kanë dhënë gjatë kësaj periudhe krize për shkak të Covid-19.

KB Peja ndërpret kontratën me trajnerin Shemsettin Bash

PRISHTINË, 17 SHKURT - Shemsettin Bash më nuk është trajner i KB Pejës. Klubi pejan ka njoftuar të mërkurën se e ka shkëputur kontratën me trajnerin turk, i cili e ka marrë drejtimin e ekipit para fillimit të këtij sezoni. Largimit i trajnerit Bash te Peja ka ardhur pasi ekipi pejan nuk e arriti triumfin në Kupën e Kosovës, turne që e kishte organizuar në palestren "Karagaçi" javën e shkuar. Peja u eliminua në gjysmëfinale nga Trepça, ekip që triumfoi në këtë garë. "KB Peja njofton se ka ndërprerë bashkëpunimin në mirëkuptim të ndërsjellë me Shemsettin Bash. Klubi e falënderon shumë Bash për punën e tij në KB Peja dhe i dëshiron sukses në të ardhmen", thuhet në njoftimin e Pejës.



Mulleri: Vuajtëm shumë, Salzburgu vërtet i fortë

MUNCHEN, 17 SHKURT - Thomas Mulleri ishte një nga lojtarët më të dobët në fushën e lojës për Bayernin. Mesfushori gjerman ka thënë pas ndeshjes se skuadra vuajti presionin e Salzburgut i cili bëri ndeshjen e jetës. "Ndihemi të mërzhitur dhe të kënaqur në të njëjtën kohë.

Salzburgu bëri, ndoshta, ndeshjen më të mirë në historinë e tyre. Komplimente edhe për atmosferën e cila ishte madhështore. Tifozët janë bukuria e këtij sporti dhe kjo u pa edhe të mërkurën. Për sa i përket ndeshjes më duhet të pranojë se vuajtëm jo pak. Nuk dolëm kurrë në

lojën tonë edhe pse kishim një kontroll të lehtë territorial. Duhet të jemi më të vendosur dhe me më shumë ritëm. Askush nuk fal asgjë, jemi Bayerni dhe duhet t'i marrim frenat e lojës në dorë. Largohemi me kokën lart nga Salzburgu me shpresën se në ndeshjen e

kthimit do të jemi më të kthjellët në lojën tonë", ka thënë Mulleri. "Kualifikimi? Nuk e di, do të flasim pas tri javësh", ka shtuar mesfushori i Bayernit. Mulleri arriti ta jepte asistimin e golit të barazimit për skuadrën e tij, duke gjetur në zonë Comanin i cili nuk fali brenda zonës.



PSG-ja përpigjet t'i bashkojë Messin dhe Ronaldon

PARIS, 17 SHKURT - Paris Saint Germaini është i interesuar për nënshkrimin e Cristiano Ronaldos nga Manchester Unitedi këtë verë. 37-vjeçari u rikthye këtë verë pas 12 vjetësh tek Unitedi, duke zgjedhur të lidhet sërish me "Djajtë e Kuq" në vend që t'u bashkohej rivalëve të Manchester Cityt, i cili dukej afër ta merrte në "Etihad" pasi ai arriti një marrëveshje për t'u larguar nga Juventus. Ronaldo besonte se do t'i bashkohej një skuadre të Unitedit të aftë për të sfiduar trofe, por kjo nuk u materializua pavarësisht prej përpjekjeve të tij më të mira, të cilat kanë dhënë 15 gola në 23 ndeshje në të gjitha garat, ata janë shumë larg ritmit në Ligën Premier dhe të eliminuar nga dy kupave vendase. Agjenti i Ronaldos, Jorge Mendes, është në bisedime me shumë



klube nga e gjithë bota dhe tashmë thuhet se ka edhe një befasi në mesin e tyre. Sipas faqes "90min", një prej klubeve është PSG, i cili dëshiron të shohë Ronaldon duke formuar një treshe të yjeve së bashku me Neymarin dhe rivalin prej kohësh, Lionel Messin. Pronarët e PSG-së,

Qatar Sports Investments, një degë e Katar Investment Authority dhe fondit sovran të pasurisë së vendit janë të prirë ta forcojnë emrin e tyre në futboll përpara Kupës së Botës më vonë këtë vit, dhe nënshkrimi i superyllit botëror Ronaldo do të jetë padyshim një ndihmë.

Phoenixi, lider në Perëndim, fitojnë edhe lakersat, Brooklyn dhe Chicago

PHOENIX, 17 SHKURT - Fitorja e shtatë radhazi për Phoenixin, që mposhti me rezultat 124-121 Houstonin dhe konsolidon pozitën në krye të renditjes në Konferencën e Perëndimit në NBA. Ndeshje me rivalitet, vendosur në fund, me Bookerin autor i 24 pikëve e Ayton 23. Ndërkohë që, 41 pikë erdhën nga lojtarët e stolit, vendimtarë në këtë sfidë. Rikthehet te fitorja



skuadra e lakersave, që mundi me rezultat 106-101 nga Utah Jazz, sfidë ku u dallua LeBron Jamesi me 33 pikë. Për Jazzin u dallua Mitchell me 37 pikë, por që s'mjaftuan. Humbet edhe ekipi i Golden States, që u mund në sekondën e fundit me rezultat 117-116 nga Denveri. Nikola Jokiq realizoi 35 pikë e 17 rebounde.

Fiton edhe Brooklyn, që mundi 111-106 New Yorkun në derbi, ndeshje ku u dalluan Thomasi me 21 pikë e Curry me 20. Në krye të renditjes në Konferencën e Lindjes ngjitet ekipi i Chicagos, që mundi me rezultat 125-118 Sacramenton, takim ku u dalluan DeRozani me 38 pikë e Whyte me 31 pikë.

REZULTATET

Orlando - Atlanta	109-130
Boston - Detroit	111-112
Indiana - Washington	113-108
New York - Brooklyn	106-111
Chicago - Sacramento	125-118
Memphis - Portland	119-123
Minnesota - Toronto	91-103
Oklahoma - San Antonio	106-114
Phoenix - Houston	124-121
Golden State - Denver	116-117
Lakers - Utah Jazz	106-101

SHKURT

Kloppi: Ne nuk ishim shumë të mirë, zëvendësuesit na e fituan ndeshjen

Liverpooli e mposhti Interin me golat e Roberto Firminos dhe Mohamed Salah, por trajneri Jurgen Klopp ka thënë se skuadra e tij nuk ka luajtur mirë në këtë ndeshje. "Ata kishim mundësi shënimi, por nuk ia dolën t'i shfrytëzonin. Dzeko shënoi u duk si mundësi, por ai ishte në pozitë jashtë lojës. Ne nuk ishim shumë të mirë, por u mbajtëm. Hendo (Henderson) u fut në lojë me këmbë të freskëta dhe ne filluam ta kontrollojmë lojën", ka thënë Klopp.

Inzaghi: Luajtëm ndeshjen më të mirë të sezonit, na mungoi vetëm goli

Interi u mposht me dy gola në "San Siro" nga Liverpooli dhe pas ndeshjes trajneri Simone Inzaghi u shpreh: "Jam i kënaqur dhe krenar. Bëmë një ndeshje të madhe, por nuk u shpërblyem me një gol që e meritonim. Ata shënuan një gol në rastin e parë që krijuan. I përgëzoja të gjithë për paraqitjen. Më vjen keq për rezultatin sepse meritonim më shumë. Mendoj se Liverpooli është një nga skuadrat më të mira të Evropës, por Interi im luajti si i barabartë. Kjo ndeshje duhet të na rrisë vetëbesimin, duhet të shërbejë si një pikënisjeje. Gjatë këtij sezoni kemi luajtur shumë ndeshje të mira, por asnjëherë përballë një kundërshtari si Liverpooli", ka shtuar Inzaghi, i cili e konsideroi si ndeshjen më të mirë të sezonit.

Kroos: Me Ronaldon asgjë nuk ishte e pamundur

Mesfushori i Real Madridit, Toni Kroos, ka folur për ish-bashkëlojtarin Cristiano Ronaldo. Dyshja ishte ndër më të mirët në epokën e artë të Real Madridit, ku fitoi tri herë trofeun e Ligës së Kampionëve. Kroos ka thënë se me Ronaldon në fushë asgjë nuk ishte e pamundur. "Në vitin 2016 humbëm 2-0 ndaj Wolfsburgut në ndeshjen e parë dhe në të dytën shënoi het trik. Me Cristianon në fushë asgjë nuk ishte e pamundur", ka deklaruar Kroos. Ndërkohë, Real Madridi në Ligën e Kampionëve dje u mposht nga PSG-ja, derisa Ronaldo me Manchester Unitedin javën tjetër do të përballlet me Atletico Madridin.

Gisin mbetet mbretëreshë e kombinimit alpin

Skitarja Michelle Gisin e ka fituar të enjten medaljen e artë në disiplinën e kombinimit alpin, duke përsëritur suksesin e Olimpiadës së kaluar në "Pyeongchang 2018". Zvicëria e arriti këtë sukses pas performancës së mirë në lëshim dhe slallom, duke pasur kohën 2:25.67, një sekondë më e shpejtë se bashkëvendësja e saj Wendy Holdener që zuri vendin e dytë. Ndërsa medaljen e bronzit e fitoi Federica Brignone nga Italia. Kjo ishte hera e dytë që Gisin siguron medalje në Lojërat Olimpikë "Pekini 2022", pasi herën e parë e mori të bronzit në super slallom.

Vritet në moshën 48-vjeçare ish-futbollisti afrikan

Ish-futbollisti i Zimbabvesë, Charles Yohane, është vrarë në Afrikën e Jugut në moshën 28-vjeçare, pasi ishte rrembyer nga vetura e tij. Yohane ishte në skuadrën debutuese të

Zimbabvesë në Kupën e Kombeve të Afrikës në vitin 2004. Ai ka punuar si trajner i futbollit dhe shofer taksi në Johannesburg, pas pensionimit nga futbollit. Trupi i tij i pajetë u

gjet në Soweto të hënën, edhe pse besohet se ai kishte vdekur të shtunën mbrëmë. "Ai u rrembye, ata e morën veturën e tij dhe e qëlluan atë me plumb në kokë", ka thënë vëllai i tij,

Lewis, për "BBC Sport". Yohane kaloi nga Zimbabveja në Afrikën e Jugut në vitin 1996 dhe luajti për ekipin elitë Wits, duke u bërë kapiten dhe duke e bërë një numër rekord

paraqitjesh, 268, nga viti 1997 deri në vitin 2006. Ai luajti për Zimbabvenë në 23 ndeshje, duke u bërë zgjedhja e parë në krahun e majtë të mbrojtjes së vendit të vet në vitin 1996.

PROTESTË!

*Proteston, refuzon, mallkon, pena e shkrimtarit:
Kur burgosen çlirimtarët, burgoset edhe
populli!*

Kur burgoset UÇK-ja, burgoset edhe liria!




“Hero në luftë, Hero në paqe” – 1



“Drenica para gjyqit” – 2



“UÇK-ja para gjyqit” – 3



“Na e ban hallall, Kosove” – 4



*“Edhe malet janë Kosova para gjyqit,
UÇK - 5*



*Murtaja e Kuqe-7
dramë, 6*

(Këta janë 7 libra publicistikë, të botuar nga Riza Greiçevci për Gjykatën Speciale të Hagës, ku po gjykohen: UÇK-ja, çlirimtarët, Drenica, liria, dëshmorët, pushka e Adem Jasharit, Kosova...!)

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Vnder control" Sh.P.K. me pronar Gëzim Rexhepin, me adresë "7 Shtatori", Mitrovica e Veriut, ka marrë vendim të shuajë biznesin me NB: 810170168, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë me këtë kompani që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavajte se svi klienti da drustvo sa "Vnder control" D.O.O sa vlasnikom Gezim Rexhepi, ulica "7 Shtatori" iz Severna Mitrovica, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom BB: 810170168 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all clients that "Vnder Control", L.T.D, in Mitrovica e Veriut has taken the decision to quit its business with NB: 810170168, The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have creditor – debtor accounts with this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

"Epoka e re"

Prishtinë, 16.02.2022



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► "Çëndrimi" SH.P.K. Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me pronar Ali Thaqi adresa, Kramovik Rahovec, shpall të pavlefshme certifikatën e nr. fiskal: 600049763 si dhe certifikatën e TVSH-së, me nr. 330024779.

► "Newco Babush Agricultural Land" L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. unik Identifikues 810547177.

► Besnik Daka shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfm " Ibrahim Fehmiu " Prizren.

► Berina Sylmetaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI -IX shfm " Haziz Tolaj " Prizren.

► Fatmir Shabanaj shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Taulant Lleshi Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

► Përparim Patoku Gjakovë, shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

► Lumturije Morina Gjakovë, shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari" Tregti.

► Bajram Sylmetaj Gjakovë, shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari.

► Jeton Lamabegu Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi".

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

